



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:232440
Datë: 23.09.2024
Numri i dokumentit: 06197153

PPP.nr. 580/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Albana Ukshini duke vendosur në çështjen juridike përmbaremore të kreditorit Sh.B., nga P., të cilin e përfaqëson Jeton Osmani, avokat nga Prishtina, kundër debitorit K.E.K. SHA., me seli në Prishtinë, lidhur me çështjen përmbaremore përmbushje e borxhit në bazë të titullit ekzekutiv-Aktgjykimit, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër urdhrit përmbaremore P.nr.461/23, të datës 29.09.2023, të lejuar nga përmbareuesi privat Besnik F.Nuhiu, për territorin e Gjykatës Themelore në Gjilan, jashtë seancës, më datë 23.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET POSHTË si i pasafatshëm prapësimi i debitorit – K.E.K. SHA, me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër urdhrit përmbaremore P.nr. 461/23 të datës 29.09.2023, të lejuar nga përmbareuesi privat Besnik F.Nuhiu, për territorin e Gjykatës Themelore në Gjilan.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat Besnik Nuhiu për territorin e Gjykatës Themelore në Gjilan, duke vepruar sipas propozimit për përmbaremore të ushtruar, nga i autorizuari i kreditorit, ka lëshuar Urdhri Përmbaremore nën shenjën P.nr. 461/23 të datës 29.09.2023, me të cilin ka lejuar përmbaremore në bazë të titullit ekzekutiv - aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr. 3021/18 të datës 02.03.2020, i plotfuqishëm me datë 25.05.2023 dhe i ekzekutueshëm nga data 14.08.2023, si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore.

Kundër këtij urdhri përmbaremore, më datë 19.10.2023 prapësim ka paraqitur përfaqësuesi i debitorit, duke i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe abrogohet urdhri përmbaremore P.nr.461/23 i datës 29.09.2023 dhe të pezullohen dhe anulohen të gjitha veprimet e ndërmarra. Kreditori më datë 27.10.2023, ka ushtruar përgjigje në prapësim, përmes së cilit i

ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri për caktimin e përmbarimit P.nr.461/23 i datës 29.09.2023, si dhe të obligohet debitori të paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Gjykata pas shikimit të shkresave të lëndës konstatoi se prapësimi i paraqitur nga debitori është **i pasafatshëm**.

Gjykata me shikimin e shkresave të lëndës vërtetoi se debitori propozimin për përmbarim, i cili përmban edhe urdhrin përmbarimor P.nr.461/23 të datës 29.09.2023 e ka pranuar me datë 10.10.2023, çka vërtetohet përmes fletëkthesës, pjesë e dosjes së lëndës. Ndërsa, kundër urdhrin të përmbaruesit privat ka paraqitur prapësim, të cilin e ka dorëzuar pranë zyrës së përmbaruesit privat më datë 19.10.2023, çka vërtetohet edhe në bazë të vulës së pranimit së këtij përmbaruesi.

Meqenëse afati për prapësim është shtatë (7) ditë nga dita e pranimit të urdhrin përmbarimor, atëherë rezulton që prapësimi është paraqitur pas skadimit të afatit prej shtatë (7) ditësh. Kjo për faktin se afati fillon të llogaritet - rrjedhë nga data 10.10.2023, ku edhe llogariten shtatë (7) ditë, atëherë dita e fundit për parashtrimin e prapësimin ka qenë data 17.10.2023. Rrjedhimisht, meqenëse se prapësimi është paraqitur me datë 19.10.2023, rezulton se është paraqitur me vonesë prej dy (2) ditësh.

Në bazë të lartcekurave dhe duke marrë për bazë se afati për paraqitjen e prapësimin është afat prekluziv, debitori ka qenë i obliguar që konform nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, prapësimin t'ia paraqes organit përmbarues brenda afatit prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të urdhrin për përmbarim.

Gjykata në kuptim të nenit 73 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
PPP.nr. 580/23, datë 23.09.2024

Gj y q t a r j a,
Albana Ukshini

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej shtatë (7) ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftueshme.